



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja  
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

ZYRA PER KOMUNIKIM ME PUBLIKUN/KANCELARIJA ZA JAVNO KOMUNICIRANJE/  
/OFFICE OF PUBLIC COMMUNICATION/

## **THIRRJE PËR APLIKIM PËR FERMERËT DHE EKONOMITË BUJQËSORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

PËR PËRFITIM NË KUADËR TË IMPLEMENTIMIT TË “PLANIT PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL 2007-13”, MBËSHTETJE PËR INVESTIME NË MASËN 2 »RISTRUKTURIMI I POTENCIALIT FIZIK NË SEKTORIN AGRO-RURAL« PËR NËN-MASËN HORTIKULTURË »PËR SEKTORIN E PEMËTARISË, PERIMTARISË, VRESHTARISË, FRUTAVE TË MALIT DHE BIMËVE MJEKUESE

### **I. Qëllimi i thirrjes për aplikim**

Qëllimi i thirrjes për aplikim është dhënia e mbështetjes financiare/granteve për investime në ferma në kuadër të Masës 2 »Ristrukturimi i potencialit fizik në sektorin agro-rural« sipas Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2007-2013, për nën-masën 2 »Për sektorin e pemëtarisë, perimekulturës dhe vreshtarisë«.

### **II. Përfituesit e pranueshëm**

Përfituesit e pranueshëm për këtë nën-masë janë personat fizik dhe juridik. Ata duhet të jenë banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës (personat fizik) ose të jenë të regjistruar në regjistrin e biznesit në Kosovë (personat juridik), ata duhet t'i përmbushin kushtet sipas kësaj thirrje për aplikim.

#### **1. Shtrirja gjeografike**

Tërë territori i Republikës së Kosovës

#### **NËN-MASA HORTIKULTURË**

#### **Sektori i Pemëve**

### **III. Kriteret specifike të pranueshmërisë për aplikuesit**

- Fermerët duhet të paraqesin dëshmi për posedimin e tokës bujqësore (toka mund të jetë pronë ose e kontraktuar për shfrytëzim);
- Në rastet e ngritjes së pemishteve të mollës në tokën e marrë me qira - e drejta e shfrytëzimit të tokës duhet të dëshmohet për së paku 15 vjet;

- Në rastet e shfrytëzimit të tokës së marrë me qira, duhet të prezantohet miratimi me shkrim i pronarit të tokës për ngritjen e pemishtes;
- Për pemishte të mollës: fermerët duhet të kenë së paku 0,50 ha tokë;
- Për pemishte me mollë, parcelat e pranueshme duhet të jenë 0,50 ha tokë (në një parcelë);
- Për dredhëza: fermerët duhet të ngrisin së paku 0,20 ha pemishte;
- Për mjedra dhe manaferra: fermerët duhet të ngrisin së paku 0,10 ha pemishte në një parcelë;
- Në rastin e dredhëzës/mjedrës dhe manaferrës, infrastruktura komplete është e domosdoshme.

#### **IV. Investimet e pranueshme**

##### **A. Për ngritjen e pemishteve të reja me mollë:**

- Ngritja e pemishteve të reja me mollë për prodhim intensiv (shpenzimet e fidanëve, përgatitja e tokës për mbjellje, shpenzimet e mbjelljes, etj.);
- Investimet në infrastrukturë:
  - a) sistemi i ujitjes pikë-pikë,
  - b) sistemi i mbajtjes,
  - c) rrethoja,
  - d) sistemi i mbrojtjes nga breshëri (rrjeta), por vetëm deri në 1 ha.

##### **B. Investimet në infrastrukturën e pemishteve ekzistuese të mollës, jo më të vjetra se tri vjet:**

- sistemi i ujitjes pikë-pikë,
- sistemi i mbajtjes,
- rrethoja,
- sistemi i mbrojtjes nga breshëri (rrjeta), por vetëm deri në 1 ha.

##### **C. Investimet për krijimin e pemishteve të reja me pemë të imta (dredhëza, manaferra dhe mjedra) si vijojnë:**

- a. Për dredhëza: fidanët, sistemi i ujitjes pikë-pikë dhe folja e zezë;
- b. Për manaferra dhe mjedra: fidanët, sistemi i ujitjes pikë-pikë.

Investimet për ngritjen e pemishtes së dredhëzës, manaferrës dhe mjedrës duhet të përfshijnë infrastrukturën komplete, siç përmendet më lart.

#### **5. Mjetet financiare për këtë nën-masë janë:**

1. Ngritja e sipërfaqeve të reja për pemishtet e mollëve: 700.000 euro
2. Mbështetje për infrastrukturën e pemishteve mollë: 200.000 euro
3. Ngritja e sipërfaqeve të reja me dredhëza, mjedra dhe manaferra: 300.000 euro

#### **6. Shpenzimet maksimale të pranueshme dhe intensiteti i ndihmës publike**

- **Për ngritjen e pemishteve të reja të mollës me infrastrukturë komplete (pa sistemin e mbrojtjes kundër breshrit):**
- Investimi maksimal i pranueshëm për 1 ari është 120 euro;
- Investimi maksimal i pranueshëm për 5/ha është 60.000 euro;
- Intensiteti i mbështetjes publike (për shpenzimet e pranueshme) është 65%, prandaj maksimumi i mbështetjes publike është 39.000 euro.

Nëse shpenzimet janë më të mëdha se investimet e pranueshme, atëherë përfituesi duhet t'i mbulojë ato nga burimet e veta.

- **Investimet për infrastrukturën e pemishteve (përveç sistemit për mbrojtjen nga breshëri):**
- Investimi maksimal i pranueshëm për 1 ari është 60 euro;
- Investimi maksimal i pranueshëm për 5/ha është 30.000 euro;
- Intensiteti i mbështetjes publike (për shpenzimet e pranueshme) është 65%, prandaj maksimumi i mbështetjes publike është 19.500 euro.

Nëse shpenzimet janë më të mëdha se investimet e pranueshme, atëherë përfituesi duhet t'i mbulojë ato nga burimet e veta. Çdo shpenzim tjetër konsiderohet si shpenzim i papranueshëm.

- **Për investimet në sistemin e mbrojtjes nga breshëri:**
- Investimi maksimal i pranueshëm për 1 ari është 120 euro;
- Investimi maksimal i pranueshëm për 2/ha është 24.000 euro;
- Intensiteti i mbështetjes publike (për shpenzimet e pranueshme) është 65%, prandaj maksimumi i mbështetjes publike është 15.600 euro.

Nëse shpenzimet janë më të mëdha se investimet e pranueshme, atëherë përfituesi duhet t'i mbulojë ato nga burimet e veta.

### **Investimet për krijimin e plantacioneve të dredhëzës, mjedrës dhe manaferrës me infrastrukturë komplete**

#### **A. Për dredhëza**

- Investimi maksimal i pranueshëm për 1 ari është 150 euro;
- Investimi maksimal i pranueshëm që i referohet deri në 2 ha, prandaj shpenzimet maksimale të pranueshme janë 30.000 euro;
- Intensiteti i mbështetjes publike (për shpenzimet e pranueshme) është 65 %, prandaj maksimumi i mbështetjes publike është 19,500 euro.

Nëse shpenzimet janë më të mëdha se investimet e pranueshme, atëherë përfituesit duhet t'i mbulojnë ato nga burimet e veta.

#### **B. Për mjedra dhe manaferra**

- Investimi maksimal i pranueshëm për 1 ari është 150 euro;
- Investimi maksimal për 1 ha është 15.000 euro;
- Intensiteti i mbështetjes publike (për shpenzimet e pranueshme) është 65%, prandaj maksimumi i mbështetjes publike është 9.750 euro.

Nëse shpenzimet janë më të mëdha se investimet e pranueshme, atëherë përfituesit duhet t'i mbulojnë ato nga burimet e veta.

**1. Dokumentacioni specifik i nevojshëm për nën-masën:**

- a) Kopjen e fletës poseduese për sipërfaqen e tokës;
- b) Kopjen e planit të lëshuar nga kadastra (për parcelën ku bëhet investimi, ngritjen e pemishtes);
- c) Kopjen e diplomës së fakultetit ose shkollës së mesme (nëse e kanë);

**2. Përfituesit e përzgjedhur duhet të dorëzojnë edhe këto dokumente:**

- a) Materiali fidanor i importuar duhet të posedoj dëshminë mbi gjendjen shëndetësore (certifikatën fitosanitare);
- b) Përfituesit që mbjellin pemishte të reja, për materialin fidanor të mbjellë duhet të posedojnë dëshmi për gjendjen shëndetësore dhe pastërtinë varietore.

## **Sektori i vreshtave për rrush të tryezës**

**3. Kriteret specifike të pranueshmërisë për aplikuesit:**

- Të paraqesin dëshmi për posedimin e tokës bujqësore. Toka mund të jetë në pronësi ose e kontraktuar për shfrytëzim minimum për 15 vjet;
- Në rastet e shfrytëzimit të tokës së marrë me qira, duhet të prezantohet miratimi me shkrim i pronarit të tokës për ngritjen e vreshtit;
- Madhësia minimale e parcelës së pranueshme për ngritjen e plantacioneve të vreshtave/investimet në plantacionet ekzistuese janë 0.20 ha;
- Madhësia minimale për ngritjen e plantacioneve të vreshtave/investimet në plantacionet ekzistuese janë së paku 0.50 ha.

**4. Investimet e pranueshme për këtë nën-masë:**

**A. Për ngritjen e plantacioneve të reja:**

- Ngritja e vreshtave të reja të rrushit të tryezës (p.sh.,shpenzimi me fidanë-material i cili përmbush të gjitha standardet të parapara sipas Ligjit për materialin fidanor 2004/13 of 28.05.2004, shpenzimet për përgatitjen e tokës, sistemi i mbajtjes standard/konvencional ose sistemi mbështetës i llojit T, etj.);
- Sistemi i ujitjes pikë-pikë (në qoftë se ka burim uji).

**B. Investimet në infrastrukturë për vreshtat ekzistuese jo më të vjetra se 2 vjet:**

- Sistemi mbështetës i llojit T dhe ai standard/konvencional;
- Sistemi i ujitjes pikë-pikë (në qoftë se ka burim uji).

**1. Mjetet financiare për këtë nën-masë janë: 200.000 euro**

**2. Shpenzimet maksimale të pranueshme dhe intensiteti i ndihmës publike**

**A.** Shpenzimet maksimale të pranueshme në rast të ngritjes së vreshtave dhe rrushit të tryezës për 1 ari është siç vijon:

- Mbjellja e sipërfaqeve të reja – 80 euro;
- Sistemi mbështetës – në rast të sistemit konvencional – 40 euro,  
- në rast të T sistemit - 80 euro;
- Sistemet e ujitjes – 14 euro;
- Investimi maksimal i pranueshëm për 1 ari është 174 euro.
- Investimi maksimal i pranueshëm për 5 ha është 87.000 euro;
- Intensiteti i mbështetjes publike (për shpenzimet e pranueshme) është 65 %, prandaj maksimumi i mbështetjes publike është 56.550 euro.

Nëse shpenzimet janë më të mëdha se investimet e pranueshme, atëherë përfituesi duhet t'i mbulojë ato nga burimet e veta.

**B.** Shpenzimet maksimale të pranueshme në infrastrukturën ekzistuese të vreshtave të rrushit të tryezës për 1 ari janë siç vijon, për:

- Sistemet e mbështetjes – në rast të sistemeve konvencionale - 40 euro,  
- në rast të sistemit T - 80 euro;
- Sistemet e ujitjes – 14 euro;
- Investimi maksimal për 1 ari është 94 euro;
- Investimi maksimal i pranueshëm për 5 ha është 47.000 euro;
- Intensiteti i mbështetjes publike (për shpenzimet e pranueshme) është 65 %, prandaj maksimumi i mbështetjes publike është 30.550 euro.

Nëse shpenzimet janë më të mëdha se investimet e pranueshme, atëherë përfituesi duhet t'i mbulojë ato nga burimet e veta, çdo shpenzim tjetër konsiderohet si shpenzim i papranueshëm.

**3. Dokumentacioni specifik i nevojshëm për këtë sektor.**

- a) Numrin identifikues të fermerit (vreshtar) i cili nxirret në Entin e Vreshtarisë dhe të Verërave;
- b) Dëshmitë kadastrale (letrën poseduese me kopjen e planit) për sipërfaqen e tokës bujqësore (duke përjashtuar të dhënat kadastrale për pyje, oborre, etj. që nuk janë tokë bujqësore);
- c) Dëshmi për pronësinë e tokës ose kopjen e kontratës që dëshmon disponueshmërinë e tokës bujqësore së paku për 15 vite pas aplikimit.

**Përfituesit e përzgjedhur duhet të dorëzojnë edhe këto dokumente:**

- a) Materiali fidanor i importuar duhet të posedoj dëshminë mbi gjendjen shëndetësore (certifikatën fitosanitare)
- b) Përfituesit që mbjellin vreshta të reja, për materialin fidanor të mbjellë duhet të posedojnë dëshmi për gjendjen shëndetësore dhe pastërtinë varietore.

## **Sektori i perimeve**

### **1. Kriteret specifike të pranueshmërisë për aplikuesit:**

#### **A. Në rast të serrave për prodhimin e perimeve**

- Dëshmi për posedimin e tokës bujqësore. Toka mund të jetë pronë ose e kontraktuar për shfrytëzim minimum për 5 vjet;
- Investimi në ngritjen/zgjerimin (konstruktimin) e serrave të reja të tipit "Tunel" ose "Bllok" nga polieteni me sipërfaqe minimale prej 500 m<sup>2</sup>;
- Investimi në ngritjen/zgjerimin (konstruktimin) e serrave të reja të tipit "Bllok" nga polieteni me sipërfaqe minimale prej 500 m<sup>2</sup>;

#### **B. Në rast të fushave të hapura për prodhimin e perimeve**

- Dëshmi për posedimin e tokës bujqësore. Toka mund të jetë pronë ose e kontraktuar për shfrytëzim minimum prej 1 viti.
- Investimet duhet të bëhen në së paku 0,50 ha;
- Përfituesit duhet të kultivojnë në 3 vitet e ardhshme vetëm perimet e cekura në sipërfaqet e përkrahura, trangujt për përpunim, shalqi, pjepër, domate, speca apo fasule si monokulturë me mbështetëse dhe rrjeta.

### **4. Investimet e pranueshme për këtë nën-masë janë:**

#### **Ngritja e serrave të reja për prodhimin e perimeve**

- Konstruktimi i serrave të reja dhe rritja e kapaciteteve prodhuese me serrat e reja
- Llojet e përkrahura të serrave:
  - Serrat e llojit "Tunnel" nga polietileni, 500 m<sup>2</sup>,
  - Serrat e llojit "Bllok" nga polieteni 500 - 2.000 m<sup>2</sup> ose 2 x 1000m<sup>2</sup>;
- Nëse serrat janë më të avancuara se specifikimet e dhëna nga MBPZHR, ato duhet të pranohen;
- Sistemi i ujitjes pikë-pikë me pajisje për plehra kristalore.

#### **Për infrastrukturën e fushave të hapura me perime**

- Sistemi i ujitjes pikë-pikë me pajisje për plehra kristalore;
- Folja plastike për mulqerim dhe rrjeta plastike për sistemin mbështetës. Kolonat mbështetëse, duhet të jenë vetëm për domate, tranguj dhe fasule;
- Folja plastike për mini tunele (shalqiri dhe pjepri).

### **4. Mjetet financiare për këtë nën-masë:**

- Fushat e hapura: 400.000 euro
- Serrat: 1,000.000 euro

### **5. Shpenzimet maksimale të pranueshme dhe intensiteti i ndihmës publike**

## **A. Për krijimin e serrave për perime**

- Shpenzimet e pranueshme për 1 ari të serrës së re: 2000 euro (por jo më pak se 5 ari);
- Sipërfaqja maksimale e pranueshme për serrat e reja: 2000 m<sup>2</sup>;
- Shpenzimet maksimale të pranueshme: 40.000 euro. Nëse shpenzimet janë më të mëdha se investimet e pranueshme, atëherë përfituesi duhet t'i mbulojë ato nga burimet e veta;
- Intensiteti i ndihmës (për shpenzimet e pranueshme) është 65 %;
- Maksimumi i mbështetjes publike është 26.000 euro.

## **B. Investimet për infrastrukturën e fushave të hapura me perime**

### **Speci**

- Investim i pranueshëm për 1 ari është 15 euro;
- Investimet maksimale të pranueshme për 3 ha janë 4500 euro;
- Intensiteti i ndihmës publike (për shpenzimet e pranueshme) është 65%, prandaj ndihma publike maksimale është 2950 euro.

### **Trangulli për përpunim**

- Investim i pranueshëm për 1 ari është 35 euro;
- Investimet maksimale të pranueshme për 3 ha janë 10.500 euro;
- Intensiteti i ndihmës publike (për shpenzimet e pranueshme) është 65%, prandaj ndihma publike maksimale është 6825 euro.

### **Shalqiri dhe pjepri**

- Investim i pranueshëm për 1 ari është 20 euro;
- Investimet maksimale të pranueshme për 3 ha janë 6000 euro;
- Intensiteti i ndihmës publike (për shpenzimet e pranueshme) është 65%, prandaj ndihma publike maksimale është 3900 euro.

### **Domate**

- Investim i pranueshëm për 1 ari është 20 euro;
- Investimet maksimale të pranueshme për 3 ha janë 6000 euro;
- Intensiteti i ndihmës publike (për shpenzimet e pranueshme) është 65%, prandaj ndihma publike maksimale është 3900 euro.

### **Fasulja si monokulturë**

- Investim i pranueshëm për 1 ari është 35 euro;
- Investimet maksimale të pranueshme për 3 ha janë 10.500 euro;
- Intensiteti i ndihmës publike (për shpenzimet e pranueshme) është 65%, prandaj ndihma publike maksimale është 6825 euro.

Nëse shpenzimet janë më të mëdha se investimet e pranueshme, atëherë përfituesi duhet t'i mbulojë ato nga burimet e veta. Çdo shpenzim tjetër konsiderohet si shpenzim i papranueshëm.

**6. Dokumentacioni specifik i nevojshëm për sektorin.**

- Dëshmi mbi pronën (të gjitha), në raste të serrave të dëshmoj pronësinë e tokës për së paku 5 vite (pronë vetanake ose me qira);
- Kopje e planit (për investimin e bërë, ngritja e serrës);
- Kopjen e certifikatës për trajnim të veçantë relevant ose dëshmi të shkruar që do të marrin pjesë në trajnimin përkatës brenda afatit për kompletimin e projektit.

## **Sektori i frutave të malit dhe bimëve mjekuese**

**1. Kriteret specifike të pranueshmërisë për aplikuesit**

- Aplikuesit e përzgjedhur duhet të marrin lejen përkatëse për të zhvilluar këtë aktivitet nga Departamenti i Pylltarisë në MBPZHR

**2. Investimet e pranueshme për këtë nën-masë janë:**

- Tharëset;
- Frigoriferët;
- Makina për pastrim;
- Makina për prerje (grirje).

**3. Mjetet financiare për këtë nën-masë: 300.000 €**

**4. Shpenzimet maksimale të pranueshme dhe intensiteti i ndihmës publike:**

Deri në 30.000 euro/projekti për përfitues

**5. Dokumentacionet specifike të nevojshme janë:**

- Dëshmia e sasisë së grumbulluar në dy vitet e fundit;
- Fleta poseduese e pronës ku do të bëhet investimi.

## **VI. Koha dhe mënyra e pranimit të aplikacioneve**

1. Data e fillimit të dorëzimit të formularit për aplikim është dita pasi të jetë publikuar thirrja për aplikim.
2. **Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 45 ditë kalendarike për »PËR SEKTORIN E PEMËTARISË, PERIMTARISË, FRUTAVE TË MALIT DHE BIMËVE MJEKUESE«.**
3. **Thirrja për aplikim do të jetë e hapur 30 ditë kalendarike për sektorin e VRESHTARISË.**

Nga data e publikimit, procedimi i aplikacioneve do të behet sipas parimit të kriterëve të përzgjedhjes të përcaktuara paraprakisht nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.



4. Investimi duhet të kryhet në afat prej 60 ditëve nga data e aprovimit të projektit, përveç për ngritjen e pemishteve të mollës dhe rrushit të tryezës, investimi mund të pranohet deri më 15 nëntor.
5. Të gjitha pagesat mbi shumën 500 euro duhet të bëhen përmes transferim bankar.
6. Përfituesi duhet të shkojë në Zyrën Komunale ose drejtpërdrejt në Zyrën Komunale Këshilluese dhe të marr dokumentet e nevojshme për të aplikuar.
7. Me përkrahjen e zyrtarit këshillues komunal ose vetë përfituesi bën plotësimin e formularit për aplikim dhe siguron dokumentet e nevojshme.
8. Formulari për aplikim dhe dokumentet e bashkangjitura duhet të dorëzohen në Zyrën Komunale për Bujqësi çdo dit pune, nga ora 9:00-15:30.

#### **VII. Dokumentet e bashkangjitura**

- ↪ Projekti investues i cili duhet të përmbajë formë standarde të përmbajtjes së projektit për projektet deri 20.000 euro.
- ↪ Plani i biznesit i formës standarde nga MBPZHR për projektet me vlerë mbi 20.000 euro.
- ↪ Një kopje e letërnjoftimit (LNJ) të vlefshme të Republikës së Kosovës (për personat fizik) ose kopjen e regjistrimit të biznesit (për personat juridik), dokumenti i cili provon fuqinë e nënshkrimit në emër të kompanisë.
- ↪ Një kopje e llogarisë bankare të vlefshme, (kartela në emër të kompanisë për persona juridik).
- ↪ Kopjen e certifikatës së numrit fiskal (për subjektet juridike).
- ↪ Vërtetimi kadastral mbi sipërfaqen e tokës së punueshme (me përjashtim të të dhënave kadastrale për pyjet, kopshtet, etj. që nuk janë tokë bujqësore), në pronësi apo një kopje të kontratës e cila vërteton disponueshmërinë e tokës së punueshme të paktën për 3 vitet e ardhshme pas dorëzimit të aplikacionit.
- ↪ Vërtetimi/dëshmi mbi përmbushjen e tatimit në pronë.

- Të gjithë përfituesit e projekteve duhet të respektojnë rregullat dhe procedurat e prokurimit publik që janë të bashkangjitura si shtojcë e kontratës që fermeri e nënshkruan me Agjencionin e Zhvillimit të Bujqësisë.

#### **X. Kontaktet dhe pikat (vendet) informuese lidhur me aplikimin**

<b>MBPZHR /AZHB</b>			
Nga e hëna deri të premtën, nga ora 10:00-12:00		e-maili	
1	Nehat Veliu	038 211 967	Nehat.veliu @rks-gov.net

**Drejtoritë Komunale të Bujqësisë**  
Nga e hëna deri të premten, nga ora 09:00-15:30

Nr.	Komuna	Personi kontaktues	Telefoni	e-maili
1	Drenas	Halit Bytyqi	044/ 170-772	<a href="mailto:bujqesia_dr@hotmail.com">bujqesia_dr@hotmail.com</a>
2	F.Kosovë	Sylejman Shabani	044/ 277-984	<a href="mailto:sulejmanshabani@hotmail.com">sulejmanshabani@hotmail.com</a>
3	Prishtinë	Ylli Demolli	044/277-610	<a href="mailto:yll_demolli@hotmail.co.uk">yll_demolli@hotmail.co.uk</a>
4	Lypjan	Njazi Ibrahimimi	044/ 111-949	<a href="mailto:nijazi_ibrahimi@hotmail.com">nijazi_ibrahimi@hotmail.com</a>
5	Podujeva	Xhafer Sekiraqa	044/ 185-127	<a href="mailto:xhafa-345@hotmail.com">xhafa-345@hotmail.com</a>
6	Shtime	Ejup Ismajli	044/ 201-876	<a href="mailto:ejup_ismajli@hotmail.com">ejup_ismajli@hotmail.com</a>
7	Obiliq	Bejtullah Mjekiqi		
8	Graçanica	Goran Gjorgjeviq	049/ 776-582	<a href="mailto:Nicic_86@hotmail.com">Nicic_86@hotmail.com</a>
9	Dragash	Flamur Sylejmani	044/ 622-121	<a href="mailto:flamursylejmani2@hotmail.com">flamursylejmani2@hotmail.com</a>
10	Rahovec	Nystret Shala	044/925-858	<a href="mailto:n.shala5@hotmail.com">n.shala5@hotmail.com</a>
11	Mamushë	Jyksen Topojan	044/ 131-781	<a href="mailto:ytopoyan@hotmail.com">ytopoyan@hotmail.com</a>
12	Prizreni	Jakup Kastrati	044/ 113-121	<a href="mailto:jakup.k@hotmail.com">jakup.k@hotmail.com</a>
13	Malishevë	Milaim Morina	044/ 302-523	<a href="mailto:milaim08@gmail.com">milaim08@gmail.com</a>
14	Suharekë	Shaqir Kryeziu	049/ 449-381	<a href="mailto:shaqa63@hotmail.com">shaqa63@hotmail.com</a>
15	Gjilan	Medin Zeqiri	044/ 212-484	<a href="mailto:medinzeqiri@yahoo.com">medinzeqiri@yahoo.com</a>
16	Viti	Veton Ademi	044/307428	<a href="mailto:V_dika@hotmail.com">V_dika@hotmail.com</a>
17	Novo Bërd	Avdi Vllasaliu	044/ 293-331	<a href="mailto:avdi.vllasaliu@hotmail.com">avdi.vllasaliu@hotmail.com</a>
18	Kamenicë	Bektesh Dermaku	044/ 428-511	<a href="mailto:bekteshdermaku@hotmail.com">bekteshdermaku@hotmail.com</a>
19	Klllokot	Dosta Mesiq	044/ 722-274	<a href="mailto:dalja-75@hotmail.com">dalja-75@hotmail.com</a>
20	Partesh	Verica Milosheviq	044/ 330-616	<a href="mailto:milosevic_verica@yahoo.com">milosevic_verica@yahoo.com</a>
21	Ranilluk	Vlladimir Stojaniviq	044/ 434-595	<a href="mailto:vlladastojanovic83@yahoo.com">vlladastojanovic83@yahoo.com</a>
22	Ferizaj	Bashkim Mani	044/130-493	<a href="mailto:b-mani@hotmail.com">b-mani@hotmail.com</a>
23	Kaçanik	Zekirja Koxha	044/ 130-047	<a href="mailto:koxha_zeki@hotmail.com">koxha_zeki@hotmail.com</a>
24	Shtërpçë	Fazli Islami	044/ 323 784	<a href="mailto:fazliislami@hotmail.com">fazliislami@hotmail.com</a>
25	Hani I Elezit	Besnik Recic	044/479-883	<a href="mailto:besnik.reci@hotmail.com">besnik.reci@hotmail.com</a>
26	Mitrovicë	Bedri Bajrami	044/ 245-821	<a href="mailto:bedribajrami_055@yahoo.com">bedribajrami_055@yahoo.com</a>
27	Vushtrri	Avdyl Feka	044/ 295-627	<a href="mailto:avdyl.feka@hotmail.com">avdyl.feka@hotmail.com</a>
28	Skenderaj	Sabit Ferizi	044/ 215-098	<a href="mailto:sabitferizi@hotmail.com">sabitferizi@hotmail.com</a>
29	Leposaviq			
30	Zubin Potok			
31	Zveqan			
32	Junik	Ali Gacaferri	044/ 997-169	<a href="mailto:aligacaferri@hotmail.com">aligacaferri@hotmail.com</a>
33	Istog	Mujë Osmanaj	044/ 429-698	<a href="mailto:mujosmanaj@hotmail.com">mujosmanaj@hotmail.com</a>
34	Deçan	Bajram Çekaj	044/ 154-890	<a href="mailto:bareci_17@hotmail.com">bareci_17@hotmail.com</a>
35	Pejë	Mehdi Mula	044/ 165-225	<a href="mailto:mmulaj@hotmail.com">mmulaj@hotmail.com</a>
36	Klinë	Rexhep Rexhepi	044/ 223-165	<a href="mailto:rexha_61@hotmail.com">rexha_61@hotmail.com</a>
37	Gjakovë	Agron Zorra	044/ 350-417	<a href="mailto:agronz1@hotmail.com">agronz1@hotmail.com</a>